



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr.27/2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga Xhevdet Abazi kryesues, Nehat Idirizi dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi për apelin e Kadri Shalaku nga fshati Dardhishtë komuna e Obiliqit, në cilësinë e kandidatit për Këshilltar në Asamblenë Komunale në Obiliq, nga radhët e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) në Obiliq, për shkak të certifikimit të rezultateve për zgjedhjet lokale 2009, në seancën e mbajtur me datë 29.03.2012 mori këtë:

V E N D I M

HUDHET poshtë apeli si i **palejuar**.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 13.03.2012 me A.nr. 27/20012 nga Kadri Shalaku kandidat për Këshilltarë në Asamblenë Komunale në Obiliq, nga radhët e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) në Obiliq, ndaj vendimit të ish-KZAP-it me A.nr. 317/2009 të datës 07.12.2009, si dhe ndaj vendimit të KQZ-së që ka të bëjë me certifikimin e rezultateve për zgjedhjet lokale 2009, respektivisht për komunën e Obiliqit.

Parashtuesi i apelit pretendon se ju ka bërë e padrejtësi gjatë numërimit të votave nga Sadik Mjeku kryesues i vendvotimit Nr.1519E/01r duke ia regjistruar 9 vota nga 34 sa do të duhej të i kishte gjithsejtë. Po ashtu parashtuesi i apelit më tutje thekson se për këtë çështje janë zhvilluar hetime nga ana e Prokurorisë Publike Komunale në Prishtinë, e cila ka kërkuar nga KQZ-ja që ta bëjë rinumërimin e votave për vendvotimin Nr. 1519E/01r, ku me ç'rast është konstatuar se ka pasur gjithsejtë 34 vota e jo 9 vota.

Parashtuesi i apelit kërkon që të udhëzohet KQZ-ja që përmes masave të kompensimit të korrigoj rezultatin e certifikuar më parë për këshilltarë në Kuvendin Komunal në Obiliq.

KREU XVI i LZP-së, Rezultatet Zgjedhore

Neni 106.3 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme përcakton:

106.3 Rezultatet e zgjedhjeve janë përfundimtare dhe detyruese atëherë kur janë certifikuar nga KQZ-ja.

PZAP-i nga shkresat e lëndës gjeti se:

apeli është i palejuar

Meqenëse KQZ-ja ka bërë certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve për 36 kuvendet komunale të Republikës së Kosovës më datë 14.12.2009 në ora 18:45, duke u bazuar në dispozitën e theksuar më lart del se rezultatet e certifikuar nga KQZ-ja janë përfundimtar dhe detyruese. Andaj duke pasur parasysh juridiksionin e PZAP-it, si dhe kompetencat e parapara me ligjin mbi zgjedhjet e përgjithshme si dhe ligjin për zgjedhjet lokale, PZAP-i konsideron se apeli është i palejuar.

Për këto arsye, bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 27/2012 më datën 29.03.2012

Kryesuesi i Panelit
Xhevdet Abazi

